

FESTOJMË NË BARAZI




DEMOKRACIA NË JETËN TONË

VESA (13), SUAD (12), ZANFINA (13), ERBLIN (12), JEHONA (12)



Ne mendojmë se demokracia është lumturi për të gjithë, ashtu edhe siç e kemi paraqitur në vizatimin tonë. Nëse dëshironi të kuptoni pse mendojmë kështu, në artikullin më poshtë e gjeni përgjigjen

Sot gjatë rrugës për këtu në „Demos-ti“, pasi hymë në Prishtinë, na e tërhoqi vëmendjen diçka. Shumë njerëz, shumica prej tyre gra dhe vajza, ishin mbledhur dhe po marshonin. Ky marshim po bëhej meqë sot është Dita



Ndërkombëtare e Gruas. Siç e dijmë, 8 marsi njihet si Dita e Gruas në të gjithë botën. Madje në shtete të ndryshme kjo ditë festohet edhe si festë kombëtare. 8 marsi shërben jo vetëm për bashkimin e grave pa dallim feje, race, kulture, gjuhe apo prejardhjeje; por edhe për të kujtuar përpjekjet e vazhdueshme dhe të pandalshme për barazi, paqe, drejtësi dhe zhvillim. Kur erdhëm në Punëtori, edukatorja e grupit tonë e mori shembull pikërisht këtë marsh, për të treguar


se të gjithë pa asnjë dallim jemi të lirë të shprehim mendimet tona. Gjithashtu, ne jemi të lirë të veprojmë dhe t'i shprehim pakënaqësitë tona. Ajo na tha se liria është vetëm njëra nga elementet e shumta të demokracisë. Elemente të tjera janë barazia, toleranca, paqja, solidariteti, etj. Ne e kuptuam se të gjitha këto elemente janë shumë të rëndësishme. Tani të gjithë duam t'i kemi të pranishme në jetën tonë. Gjithë këto elemente duhet t'ua ofrojmë të tjerëve. Kështu e kemi jetën më të mirë dhe të mbushur me dashuri e lumturi. Kur i ke të gjitha këto elemente në jetën tënde, si mund të mos jesh i/e lumtur? E pikërisht, demokracia na bën të lumtur. Ne kemi edhe shumë të drejta si: e drejta e votës, e shkollimit, e shprehjes së lirë, etj. Ndërsa kemi dy lloje të demokracisë: demokracia direkte dhe ajo përfaqësuese. Demokracia direkte është atëherë kur populli merr vendime aty për aty. Ndërkaq, ajo përfaqësuese, kur populli zgjedh përfaqësuesit e vet, të cilët marrin vendime për ne.



Ne, demokratët punëtorë

PROCESI ZGJEDHOR DHE QYTETARËT

REIS (12), ERDI (12), LEONA (12), ELJESA (13)




Në këtë pjesë, grupi ynë ka shkruar për zgjedhjet dhe rëndësinë që kanë ato në jetën tonë

Gjithmonë është më mirë të kesh mundësi të zgjedhësh. A po mendoni edhe ju pse? Kur nuk kemi mundësi të zgjedhim, atëherë duhet të bëjmë gjëra që nuk na pëlqejnë. Kjo sepse nuk kemi zgjedhje tjetër. Por, kur kemi alternativa të ndryshme është gjithmonë më mirë. E në demokraci, ne si qytetarë bëjmë zgjedhje shumë të rëndësishme për vendin tonë. Ky proces njihet si procesi më i rëndësishëm demokratik. Kjo ngase qytetarët e vendeve demokratike përmes këtij procesi zgjedhin udhëheqësit e vendit të tyre.


Meqë të zgjedhësh udhëheqësit e vendit është përgjegjësi e madhe, për të marrë pjesë në këtë proces ne

duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare.

Vota jonë gjithmonë duhet të jetë e lirë dhe asnjëherë nuk duhet të imponohet. Për shembull, unë Erdi dhe vëllau im Erindi nuk është e thënë të votojmë për të njëjtën parti. Nëse ai e voton Partinë Molla, kjo nuk nënkupton se edhe unë duhet ta votojë po atë parti. Unë e votoj Partinë Dardha, sepse mendoj që është zgjedhja më e mirë. Kështu duhet të veproni edhe ju qytetarë të dashur. Gjithashtu, të mos harrojmë se kemi dy lloje të zgjedhjeve. Janë zgjedhjet parlamentare, ku ne i zgjedhim deputetët. Kurse, në zgjedhjet lokale ne i zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse dhe asamblistët. Këtu po ndahemi nga ju, me shpresën se e kuptuat rëndësinë e votës.



Ne jemi të lirë të zgjedhim aktivitetin tonë të preferuar



Cila është ngjyra jote e preferuar? Bëj zgjedhjen tënde

SHUMË DUAR BËJNË SHUMË PUNË


ELTON (12), DIANA (12), ERIONA (12), EDONIS (12)



Qytetar është çdo person, i cili jeton brenda kufijve të një shteti të caktuar dhe ka leje qëndrimi në atë vend, qoftë si vendas i atij vendi apo si refugjat. Por, nëse jeni të interesuar të dini se çka i dallon qytetarët mes vete, do t'iu tregojmë ne

Në demokraci të gjithë gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes. Kjo nënkupton se liria për t'u angazhuar dhe për ta ndihmuar vendin i jepet secilit. Por, sa e shfrytëzojnë qytetarët këtë liri, mbetet e tëra në duart e tyre. Angazhimi i qytetarëve varet nga vullneti dhe shpirti human që ata kanë dhe që mund ta tregojnë. E

Shumicën e të drejtave që populli i gëzon janë falë punës së qytetarëve aktiv. Këtu mund të përmendim dhe reagimet e qytetarëve për pakënaqësitë që mund t'i kenë. Nëse popullit i bëhet një e padrejtë dhe nëse nuk reagon dhe nuk e ngrit zërin për këtë, atëherë përgjegjësia mbetet tek qytetarët dhe mos aktivizimi i tyre. Përveç të drejtave, qytetarët kanë edhe përgjegjësi. Ato lidhen me: respektimin e ligjeve, respektimin e njëri-tjetrit, mbrojtjen dhe pastrimin e ambientit dhe pagesën e rregullt të taksave. Këto përgjegjësi mundohemi që edhe ne dhe familjet tona t'i respektojmë sa më shumë. Për shembull, prindërit tanë paguajnë taksat, respektojnë ligjet, si dhe votojnë. Ata bëhen shembull për ne, kurse ne do të bëhemi shembull për gjeneratat e tjera.




pikërisht, vullneti dhe dëshira për të kontribuar për vendin i dallon qytetarët aktiv nga ata jo aktiv. Kjo me një fjalë përkufizohet si qytetari aktive, e cila nënkupton angazhimin e qytetarëve për të përmirësuar jetën në komunitet. Qytetarë aktiv janë ata të cilët: bëjnë punë vullnetare, informohen drejt apo marrin pjesë në procesin zgjedhor. Ata mund të formojnë organizata jo qeveritare, kur e shohin të nevojshme për të shtrirë ndikimin e tyre në sfera edhe më të gjera se më parë.



Të mençur dhe shumë aktiv

KUVENDI, INSTITUCION LIGJVËNËS

DRILONA (12), KOSOVARE (12), ERZA (13), LEART (12), RINESA (12)



Si lidhet Kuvendi me jetën time? Çfarë vlere ka ai në jetën e secilit qytetar? Këto dhe shumë të tjera do t'i mësoni nga artikulli ynë mbresëlënës


Në një shtet demokratik, pushteti buron nga populli. Përfaqësuesit e zgjedhur prej tij, janë ata të cilët ushtrojnë pushtetin legjislativ. Kuvendi i Kosovës ka gjithsej 120 deputetë, të cilët i zgjedh populli. 20 prej këtyre vendeve janë të garantuara për komunitetet jo shumicë. Këto vende garantojnë duke e ditur se jemi shtet demokratik dhe secilit qytetar i takon e drejta për të qenë vendimmarrës në jetën e vet.

Kuvendi ndër të tjerash është institucion ligjvënës, që nënkupton se deputetët kanë të drejtë të propozojnë ligje, si dhe t'i miratojnë ato me anë të votave. Ai zgjedh Qeverinë, dhe për këtë arsye kontrollon punën e saj. Po ashtu, Kuvendi ka të drejtë edhe ta shkarkojë atë.

Tri funksionet kryesore të Kuvendit janë: funksioni përfaqësues, funksioni legjislativ dhe funksioni kontrolues. E nëse pyesni se si lidhet Kuvendi me jetën tonë, atëherë në këtë pjesë të artikullit do t'iu tregojmë.

E kemi zgjedhur pikërisht ligjin për emrin personal për të treguar se edhe këtu ka ndikim Kuvendi ynë. Ky ligj thotë: „emri personal i garanton qytetarit identitetin, ruajtjen e personalitetit dhe dinjitetit të tij.“ Si dhe nga ligji në fjalë tregohet se: „emri personal është e drejtë e qytetarit dhe përdoret për identifikimin dhe dallimin e tij.“

E shihni pra, qytetarë të dashur, se edhe e drejta e emrit sigurohet me anë të ligjit? Andaj, dijeni se Kuvendi ndikon shumë në jetën tonë. Veçse edhe ne duhet të jemi të kujdesshëm kur bëhet fjalë për zbatimin e ligjeve. Pra, le të përpiqemi të gjithë së bashku t'i respektojmë sa më shumë ato.



E drejta ime të kem emër dhe identitet personal



Gazetarët margjaritarë të Kuvendit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Fazli Grajçevci“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Leshkoshiq, Obiliq